



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:012254

Datë: 25.02.2022

Numri i dokumentit: 02756917

PKR.nr. 40/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, sipas Kryetarit të trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurit H.L., i akuzuar për shkak të veprës penale: mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 366 par.1, të KPRK, sipas aktakuzës së PP/I.nr.16/22, të dt. 24.02.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, me dt. 25.02.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Agron Galani të pandehurit H.L., mbrojtësit të tij av. Sh.Sh., sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H.L., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr....., të lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i lindur me, në fsh., K. P., me vendbanim në fsh. K. P., me vendbanim të përkohshëm në Gjermani, i biri idhe nënës, e gjinisë ka të kryer shkollën fillore, me profesion, puntor në ndertimtari i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, posedues i tel.nr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

-Më parë e gjerë me dt.08.01.2022, rreth orës 16:35, në fshatin K. P..., në mënyrë të pa autorizuar dhe në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një (1) pistoletë me gas e llojit Zoraki 1917-T me numër serik 1219-001642. kalibër 9 mm P.A.K, një (1) karikator të njëjtës armë, e të cilat armë zyrtaret

policor- Njësia e Hetimeve në Pejë, pasi kanë ndaluar automjetin me, në të cilin i pandehuri kishte qenë pasagjer, nga i njëjti kanë sekuestruar armën në fjalë.

- me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69,70, nenit 366 par.1 dhe par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 400(katërqind)euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit i konfiskohet, një (1) pistoletë me gas e llojit Z..., me numër serik kalibër .. mm ... një (1) karikator të njëjtës armë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/I. nr. 16/22, të dt.24.02.2022, kundër të pandehurit, H.L., i akuzuar për shkak të veprës penale: mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve, nga neni 366 par.1, të KPRK.

Bashkë me aktakuzën Prokuroria i ka dërguar Gjykatës edhe njoftimin për Marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, në ç ’mënyrë është njoftuar Gjykata për detajet dhe është lutur që të mbahet shqyrtimi fillestar sa më shpejtë që është e mundur .

Gjykata me dt. 25.02.2022, ka mbajtur seancën për shqyrtimin e Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent kanë qenë prokurori i shtetit Agron Galani, i pandehuri H.L. dhe mbrojtësit i tij sipas detyrës zyrtare av. Sh.Sh..

Në seancën gjyqësore, ku u shqyrtua Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë, mbrojtësi i të pandehurit av. Sh.Sh. ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes.

I pandehuri H.L., është deklaruar se e pranon Marrëveshjen e arritur në Prokurori.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sipas kushteve të Marrëveshjes.

Me rastin e shqyrtimit të Marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sipas nenit 247 par 1, lidhur me nenin 233 par 18 të KPP-së, Gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar, apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 253 par 1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 233 par 18 i KPP-së, andaj ka pranuar Marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me Marrëveshjen, Gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin e lartë cekur, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit Gjykata për të pandehurin, mori parasysh lartësinë e dënimit të propozuar me Marrëveshje si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1, të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori pranimin fajësisë sipas marrëveshjes dhe faktin se i pandehur me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, i njëjti ka pohuar se ndjen keqardhje, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-se.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet, një (1) pistoletë me gas e llojit ..., me numër serik kalibër ... mm ..., një (1) karikator të njëjtës armë

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,
PKR.nr.40/22 dt. 25.02.2022**

Sekretarja Juridike
Fitore Bojku

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita
e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
e nëpërmjet të kësaj gjykate